

Liridona Sinishtaj • Eljon Doçe

FUQIA E FJALËS

LETËRSIA 4

Për klasën e katërt të shkollës fillore

LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2020

Liridona Sinishtaj Eljon Doçe

FUQIA E FJALËS

LETËRSIA 4

PËR KLASËN E KATËRT TË SHKOLLËS FILLORE

LIBRI I MËSUESIT

MOÇ RIJEČI

KNJIŽEVNOST 4

PRIRUČNIK ZA ČETVRTI RAZRED OSNOVNE ŠKOLE

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Për botuesin: Pavle Goranoviq

Kryeredaktor: Radulle Novoviq

Redaktor përgjegjës: Llazo Lekoviq

Redaktor i librit: Dimitrov Popoviq

Recensues: Dr. Marko Camaj
Prof.dr. Fatbardha Fishta
Islam Dreshaj
Prof.as.dr. Fatmir Vadohej
Prof. dr. Vehbi Hoti

Dizajni dhe faqosja: studio ZUNS

Korrektor: Dimitrov Popoviq

Redaktore teknike: Dajana Vukçeviq

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2385-0
COBISS.CG-ID 17050116

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 10903-119/20-3335/12 të datës 24. 07. 2020
e ka miratuar këtë komplet të Tekstit mësimor për përdorim në shkollat fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2020

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
Tema 1. RIKTHEHEMI NË SHKOLLË.	7
Lexojmë - "Në mes të shtatorit", R. Çupi	7
Tema 2. SHOQJA E TALENTUAR	9
Lexojmë- "Ani pianistja", Sh.Vreto	9
Tema 3. FUQIA E FJALËS	11
Lexojmë- "Fjala është e vogël shumë", O. Grillo.....	11
Tema 4. E SHTRENJTA SHTËPI	13
Lexojmë- "Harabeli", D. Agolli	13
Tema 5. NË BOTËN E MAGJISË	15
Lexojmë- "Princesha mollë", I. Kalvino	15
Tema 6. KUPTIMI I LUMTURISË	17
Lexojmë- "Lumturia vjen prej njeriut", V. Kikaj.....	17
Tema 7. KUJDESI NUK ËSHTË KURRË I TEPËRT.	19
Lexojmë- "Luani, dhelpra dhe kafshët e tjera", Ezopi	19
Tema 8. NGJYRAT E VJESHTËS	21
Lexojmë- "Shtatori", D. Kostiq	21
Tema 9. DUAJE EMRIN TËND	23
Lexojmë- "Gentiana", E. Maqellara.....	23
Tema 10. PROJEKT	25
EJA ME MUA NË MUZE	25
Tema 11. ÇËSHTJE KOKE	27
Lexojmë- "Edhe ti nuk e gjen këtë kokë", Popullore	27
Tema 12. Vjeshta e artë.	28
Lexojmë- "Vjeshta", Xh. Spahiu.....	28
Tema 13. TË NJOHIM RRËNJËT TONA	30
Lexojmë- "Mikpritja shqiptare", M. Milani	30
Tema 14. NJIHU ME ANËN	32
Lexojmë- "Historia e Anës", L. M. Montgomëri.....	32
Tema 15. TË NJOHIM HERONJTË TANË	34
Lexojmë- "Portreti i Skënderbeut", I. Kadare.....	34
Tema 16. MOTRA GUXIMTARE	36
Lexojmë- "Motra u nis për rrugë", A. Berisha	36
Tema 17. ATMOSFERË FESTIVE	38
Lexojmë - "FishekJarrët", A. Mamaqi.....	38
Tema 18. RËNDËSIA E GJUHËS.	40
Lexojmë- "Për gjuhë e shkrim", E. Mekuli	40
Tema 19. MIQTË NUK HIDHEN POSHTË	42
Lexojmë- "Tre qetë dhe ujku", Popullore.....	42
Tema 20. NJË KËSHILLË ME VLERË.	44
Lexojmë- "Mirësi", M. Karen	44

Tema 21. PROJEKT	46
MOS HARRO-DATA TË RËNDËSISHME	46
Tema 22. NJË PORTRET FISNIK	48
Lexojmë- “Malësores”, Z. Gjuravçaj	48
Tema 23. MENÇURIA E POPULLIT	50
Lexojmë- “Fjalët e urta dhe gjëgjëzat”, Popullore	50
Tema 24. SHOKU YT, LULI	52
Lexojmë- “Luli i vocërr”, Migjeni	52
Tema 25. TEATRI I KLASËS	54
Lexojmë- “Vëlla e motër”, E. Daliu	54
Tema 26. PRANVERA ERDHI!	56
Lexojmë- “Vallja e pranverës”, N. Berisha	56
Tema 27. PRINC PËR NJË DITË	58
Lexojmë- “Princi dhe i varfëri”, M .Tuen	58
Tema 28. FUQIA E MENÇURISË	60
Lexojmë- “Baresha, gjyshi dhe i dituri”, Popullore	60
Tema 29. TË DUAM VENDIN TONË	62
Lexojmë- “Rritu vendi im”, R. Hoxha	62
Tema 30. PAKUJDESITË E VOGLA	64
Lexojmë- “Një gërvishtje e lehtë”, T. Papuçiu	64
Tema 31. AVENTURË VERORE	66
Lexojmë- “Në Bregun e Pulëbardhave”, H. Ulqinaku	66
Nga Ditari i leximeve	68

PARATHËNIE

I nderuar mësues/e nderuar mësuese,

Në përpjekje për të lehtësuar punën tuaj si edhe për të rritur rezultatet e saj me nxënësit, vjen teksti i Librit të Mësuesit.

Ky tekst është konceptuar si një material ndihmës e sugjerues në të cilin janë parashikuar hapat kryesorë nëpër të cilët ecën mbarëvajtja e procesit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies në klasë.

Ndarjet që ndërtojnë Librin e Mësuesit janë:

Skeda kryesore, e cila përmban të përmbledhura të dhënat e çdo mësimi të ri (vepra, autori, gjinia, burimet, metodologjia dhe veprimtaritë, kompetencat e fituara si dhe rezultatet e arritura).

Hapi I, i cili parashikon hapat fillestarë të orës së mësimi si shënimi në tabelë i titullit të mësimi (për të drejtuar vëmendjen), sqarime paraprake rreth temës dhe autorit, leximi në klasë i pjesës, leximi i fjalorthit, fjalët kyç etj.

Hapi II, i cili përqendrohet kryesisht në rubrikat **Të kuptojmë** tekstin dhe **Të analizojmë** tekstin, të cilat zhvillohen në klasë dhe duke qenë interaktive synojnë rritjen e aftësisë analitike nga ana e nxënësit/nxënës.

Hapi III, synon të nxisë gjykimin kritik dhe përfshirjen aktive në punën në grup të nxënësit/nxënës përmes rubrikave **Si mendon**, **Diskutoni**, **Provoje dhe ti**, **Punë në grup etj.**

Hapi IV, i kushtohet punës individuale që nxënësi/nxënësja kryen në mënyrë të pavarur, jashtë orës së mësimi dhe që lidhet me rubrikën **Detyrë**.

Shënime, është hapësira e mësuesit/mësueses për të bërë komente, shënime apo vërejtje të caktuara lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Synimi ynë ka qenë që modeli i mësimi që ofrohet të jetë i tillë që ta vendosë nxënësin/nxënësen në qendër të orës së mësimi në mënyrë që të zhvillohen sa më shumë shprehitë dhe aftësitë analitike e kritike, duke nxitur debatin në klasë si edhe duke i dhënë përparësi formimit të gjykimit të pavarur të nxënësit.

Ne shpresojmë që teksti do të jetë një ndihmesë që do të lehtësojë punën tuaj si edhe do të rrisë cilësinë e mësimdhënies së lëndës së Letërsisë për klasën e katërt.

Me respekt,

Autorët

TEMA MËSIMORE 1

Rudina Çupi

NË MES TË SHTATORIT

Tema mësimore: RIKTHEHEMI NË SHKOLLË

Titulli i temës: "Dita e parë e shkollës"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Rudina Çupi

Burimet: Teksti bazë dhe materiale shtesë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi/nxënësja është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur poezinë, të gjejë figurat letrare dhe të analizojë poezinë duke dalluar motivin dhe mesazhin e poezisë.

Hapi I

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin/nxënësen.

Tema: "Në mes të shtatorit"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *poezi, varg, metaforë, shtator, shkollë, shokë, shoqe, mësuese, etj.*

Hapi II

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Për cilën stinë bën fjalë kjo poezi?
- Si përshkruhet atmosfera e nisjes së shkollës nga autorja e poezisë? A është ajo një atmosferë e gëzuar?
- Si kanë ndryshuar shokët dhe shoqet në fillimin e vitit shkollor?
- Çfarë nuk ka ndryshuar shumë?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Gjej në tekst fjalët që përshkruajnë muajin shtator dhe që janë karakteristike për stinën e vjeshtës.

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiket të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat: **Si mendon?, Diskutoni, Provoje dhe ti, Punë në grup dhe Këshillë.**

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika Diskutoni:
Diskutoni se si ka nisur ky vit i ri shkollor për ju?
Çfarë ka ndryshur mes teje dhe shokëve/shoqeve të klasës?
A ndihesh më i rritur këtë vit?
Cilat janë objektivat që i ke vënë vetes për këtë vit shkollor

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Shkruaj zotimet (premtimet që ti i bën vetes) e tua si nxënës në fillim të këtij viti shkollor dhe rikthehu edhe një herë kësaj detyre të parë për klasën e katërt në lëndën e Letërsisë për të parë nëse i ke mbajtur premtimet e tua.

SHËNIME:

This image shows a blank sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Shpresa Vreto

ANI PIANISTJA

Tema mësimore: SHOQJA E TALENTUAR

Titulli i temës: "Ani pianistja"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Shpresa Vreto

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi/nxënësja është në gjendje të lexojë prozën me intonacionin e duhur, të dallojë pjesët përbërëse të saj (hyrje, zhvillim, përfundim) dhe të përmbledhë tekstin me fjalët e veta.

Hapi I

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin/nxënësen.

Tema: Shoqja e talentuar, "Ani pianistja"

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autorja e re që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të kësaj autoreje si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *talent, shoqe, zili, zemërgjerësi, pendesë, falje etj.*

Hapi II

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

1. Cilët janë fjalët që autorja përdor për të përshkruar Anin në fillim të tregimit?

Ajo ishte:

- a) truphedhur

b) _____

c) _____

d) _____

e) _____

2. Për çfarë arsye u bënë ziliqare dy shoqet e Anit?

3. Përse qeshën ato? Çfarë gabimi bëri Ani në fillim të koncertit?

4. A ndikoi për keq gabimi i Anit në fillim të koncertit në interpretimin e saj në piano? Si e pritën këtë interpretim shikuesit e pranishëm në koncert?

5. Si e pritën shokët e klasës të nesërmen Anin në shkollë? Po shoqet e saj ziliqare çfarë i bënë asaj?

6. Si reagoi Ani ndaj surprizës së pakëndshme të shoqeve të saj? A i tregoi ajo mësueses?

7. Çfarë bënë më vonë shoqet e Anit? A e kuptuan ato gabimin e tyre dhe si u përpoqën t'i kërkonin falje asaj?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

- b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve kërkesën:

Lexoni edhe një herë me vëmendje tekstin dhe më pas përpikuni të gjeni pjesët përbërëse të tij (**hyrje, zhvillim, mbyllje**).

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?, Diskutoni, Provoje dhe ti, Punë në grup dhe Këshillë**.

Për këtë orë mësimore parashikohen rubrikat.

Si mendon:

Ani nuk i tregoi mësueses dhe as drejtorit të shkollës se kush e mbylli në banjo dhe i hodhi ujë të ngjyrosur edhe pse ajo kishte të drejtë ta bënte këtë gjë në mënyrë që shoqet e saj ziliqare të ndëshkoheshin për atë që ato i bënë. Ani nuk u hakëmor. A mendon se ajo kishte frikë të tregonte apo sepse ishte zemërgjerë dhe i fali shoqet e saj? Si do ta vlerësoje ti këtë gjest?

Diskutim:

Historia e Ani pianistes është një shembull sesi dukuria e bullizmit përhapet nëpër shkolla dhe sesi ajo ndikon në mbarëvajtjen në mësim, por edhe sesi bullizmi ndikon shpesh në mënyrë afatgjatë në jetën e fëmijëve edhe jashtë mjediseve të shkollës.

Mendoni që në shkollën apo klasën tuaj ka raste të tilla të ngjashme?

Nëse po, cila është ideja që ju propozoni për zgjidhjen e këtyre raste? Kërkoni edhe ndihmën e mësuesit/mësueses në këtë diskutim.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Pasi ke lexuar tregimin “Ani pianistja”, mendo për ndonjë rast të ngjashëm, ku shokët ose shoqet janë sjellë në mënyrë të padrejtë ndaj teje ose ndaj dikujt që ti njeh. Shkruaje rastin dhe përpiku që të përshkruash ndjesitë që ke provuar kur e ke dëgjuar ose kur ke parë diçka të tillë.

SHËNIME:

TEMA MËSIMORE 3

Odhise Grillo

FJALA ËSHTË E VOGËL SHUMË

Tema mësimore: FUQIA E FJALËS

Titulli i temës: "Fjala është e vogël shumë"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Odhise Grillo

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë poezinë me intonacionin e duhur, të gjejë figurat letrare, motivin dhe porosinë (mesazhin) e poezisë.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: **"Fjala është e vogël shumë"**

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *fjala, shkronja, shokët, ura etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën Të kuptojmë tekstin dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Kujt ia kushton autori këtë poezi?

A është e madhe fjala për të?

Cila është porosia që autori i kësaj poezie na jep?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Gjej në tekst figurat letrare (krahasimet dhe epitetet) të cilat përdor autori për të karakterizuar fuqinë e fjalës.

Fjala për të është:

(I)

a) e vogël (epitet)

b) _____

c) _____

d) _____

(II)

a) si mjaltë (krahasim)

b) _____

c) _____

d) _____

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiqet të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Pse duhet të jemi të kujdesshëm kur flasim?

Provo të bësh edhe ti një poezi të shkurtër për fjalën dhe lexoje para klasës.

This image shows a single sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Dritëro Agolli

HARABELI

Tema mësimore: E SHTRENJTA SHTËPI

Titulli i temës: "Harabeli"

Autori i pjesës së për zgjedhur: Dritëro Agolli

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë poezinë me intonacionin e duhur, të gjejë figurat letrare, të diskutojë lidhur me temën dhe motivin e poezisë duke nxjerrë mesazhet e saj

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: E shtrenjta shtëpi, "Harabeli"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *shpezë udhëtarë, shtërg, dallëndyshe, harabel, fole, shtëpi etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Cilat janë shpezët që u larguan nga foletë e tyre?

Cila prej këtyre shpezëve nuk u largua nga shtëpia e vet?

Autori nuk e ka tregon hapur stinën për të cilën po flet? Cila stinë është ajo? Si e gjete?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Si ju duket se ndihet harabeli kur sheh se të gjithë shpendët e tjerë janë duke lënë foletë e tyre dhe po largohen?

Është ai:

a) i gëzuar

b) i trishtuar

Gjej në tekst vargjet dhe fjalët e përdorura që shprehin gjendjen e brendshme të harabelit.

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënë, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruar për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?**, **Diskutoni**, **Provoje dhe ti**, **Punë në grup** dhe **Këshillë**.

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika

Si mendon:

Në fund të strofës së parë autori ka përdorur fjalën “folë”, ndërsa në fund të strofës së tretë, pra në fund të poezisë, ka përdorur fjalën “shtëpi”.

Ju e dini që foleja i përket botës së kafshëve, ndërsa shtëpia asaj të njerëzve. Fakti që autori ka bërë një përzgjedhje të tillë të fjalëve, a mendoni që poezia do të thotë diçka më shumë edhe për botën e njerëzve sesa për atë të kafshëve?

A kemi këtu përdorim të alegorisë si figurë letrare?

Rilexojeni edhe një herë poezinë nga ky këndvështrim dhe përpquni të gjeni aspektin njerëzor në këtë poezi.

Diskutoni:

Sa i vështirë është largimi i njeriut prej shtëpisë së vet? Çfarë pasojash sjell ky largim?

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës Detyrë shtëpie dhe që për këtë orë mësimore është:

A keni pasur ju raste kur një i afërmi juaj ose një person i dashur për ju është detyruar të largohet (ashtu si harabeli në këtë poezi) nga shtëpia (kupto: vendlindja) e tij? Cilat kanë qenë ndjenjat që ju keni provuar kur ky person është larguar? Shkruajini një letër atij personi ku t'i tregoni këto ndjenja.

SHĚNIME:

[illegible]

TEMA MËSIMORE 5

Italo Kalvino

PRINCESHA MOLLË

Tema mësimore: NË BOTËN E MAGJISË

Titulli i temës: "Princesha mollë"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Italo Kalvino

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë përrallën me intonacionin e duhur, të dallojë personazhet, pjesët përbërëse të përrallës si dhe të kuptojë botën fantastike të saj.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Princesha mollë"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *magji, princ, mollë, mbretëreshë, njerë etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Përse ishte e pikëlluar mbretëresha? Çfarë i mungonte asaj?

Si e bindi princi mbretëreshën që t'i falte mollën?

Për çfarë po fillonte të dyshonte njerka e princit? Si veproi ajo për të zbuluar të fshehtën e tij (princit)?

Çfarë i bëri njerka mollës pasi e gjeti?

Si arriti ta shpëtonte shërbëtori mollën e mbytur në gjak?

Si përfundon përralla? Po me njerken çfarë u bë?

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi/nxënësja bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?, Diskutoni, Provoje dhe ti, Punë në grup dhe Këshillë.**

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika

Si mendon?:

A janë të rëndësishme përrallat? Përse? Çfarë mësojmë ne prej tyre?

Provoje dhe ti:

Ritregoje edhe një herë para klasës përrallën me fjalët e tua. Si ishte reagimi i shokëve të klasës pasi të dëgjuan? Po ti, si u ndjeve?

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës Detyrë shtëpie dhe që për këtë orë mësimore është:

Pyet prindërit ose gjyshërit për përrallat që ata të kanë treguar. Kush ua ka mësuar atyre? Sill një përrallë në klasë dhe përpiku ta tregosh atë ashtu siç ta kanë treguar ty.

SHĚNIME:

[illegible]

Vehbi Kikaj

LUMTURIA VJEN PREJ NJERIUT

Tema mësimore: KUPTIMI I LUMTURISË

Titulli i temës: "Lumturia vjen prej njeriut"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Vehbi Kikaj

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë, të analizojë tekstin në prozë, të gjejë pjesët përbërëse dhe në fund, të nxjerrë motivin dhe mesazhin e tregimit.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Lumturia vjen prej njeriut"

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *princi, pallati, oborrtarët, fshatari, lumturia etj.*

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Pse nuk ishte i lumtur princi?
Ku zhvillohet ngjarja?
Pse njerëzit nuk e donin princin?
Çfarë mësojmë nga kjo pjesë?
Po ti si do të silleshe me princin?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

- b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Sa vite kaluan pa i folur oborrtarët princit:

- a. Dy
b. Pesë
c. Tri
d. Shumë

Çfarë cilësish kishte fshatari:

- a. I zgjuar
b. I vrazhdë
c. Zemërgjerë
d. I gëzueshëm
e. I trishtë

"Tri ditë s'mund të tregohet për thesarin që kishte. Por kushedi edhe sa ditë do të më duheshin të tregoj për zemrën e tij."- Shkruaj me fjalët tua se çfarë kupton nga kjo pjesë?

Ezopi

LUANI, DHELPRA DHE KAFSHËT E TJERA

Tema mësimore: KUJDESI NUK ËSHTË KURRË I TEPËRT

Titulli i temës: "Luani, dhelpra dhe kafshët e tjera"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Ezopi

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur fabulën, të dallojë personazhet, të mbajë qëndrim me veprimet e personazheve, të kuptojë alegorinë e fabulës dhe të arrijë në nxjerrjen e porosisë (mesazhit) të saj.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Luani, dhelpra dhe kafshët e tjera"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *princi, pallati, oborrtarët, fshatari, lumturia etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Përse i thirri luani kafshët në guvën e tij?

Cilat ishte kafsha që u fut e para që të dëgjonte amanetin e luanit? Po kafsha e dytë? Po e treta?

Cila nga kafshët që tregohen në këtë fabul nuk pranoi të futej në guvën e luanit që të dëgjonte amanetin e tij? Përse nuk pranoi ajo?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet: Sa personazhe ka kjo fabul?

a) luani

b) _____

c) _____

d) _____

e) _____

A u tregua dhelpra e mençur që nuk hyri në guvën e luanit para se të dilnin kafshët e tjera që kishin hyrë para saj?

Për çfarë po dyshonte dhelpra që nuk hyri brenda?

Gjej fabula të tjera të cilat të kenë dhelprën si personazh brenda tyre. Çfarë vëren, cili është tipari kryesor që ka dhelpra në të gjitha këto fabula?

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiqet të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?**, **Diskutoni**, **Provoje dhe ti**, **Punë në grup** dhe **Këshillë**.

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika **Si mendon?**

Fabula e mësipërme na mëson që të jemi të kujdesshëm para se të bëjmë veprime për të cilat nuk jemi të sigurt. Të ka ndodhur ndonjë rast kur ti nuk ke bërë ndonjë veprim të caktuar, sepse nuk ke qenë i sigurt që ky veprim ishte veprimi i duhur? Trego si ke vepruar.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Lexo fabula të tjera nga Ezopi. Cila të pëlqeu më shumë? Shkruaj pse.

SHËNIME:

20

TEMA MËSIMORE 8

Dushan Kostiq

SHTATORI

Tema mësimore: NGJYRAT E VJESHTËS

Titulli i temës: "Shtatori"

Autori i pjesës së për zgjedhur: Dushan Kostiq

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë poezinë me intonacionin e duhur dhe të gjejë figurat letrare, të dallojë strukturën poetike, temën dhe motivin e poezisë si dhe të arrijë të gjejë mesazhin e saj.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Shtatori"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *vjeshtë, ngjyra, gjethe, dallëndyshe, nxënësi, etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Cilat janë ngjyrat me të cilat portretizohet stina e vjeshtës?

Çfarë thotë dallëndyshja?

Çfarë shkruan nxënësi?

Po shtatori, çfarë thotë?

Si ju duket atmosfera vjeshtore në këtë poezi? A ka ajo trishtim apo përshkruhet me nota të gëzuara?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën Të analizojmë tekstin duke u drejtuar nxënësve kërkesën:

Shkruaj fjalët çelës të cilat japin idenë e vjeshtë, p.sh. ngjyra e gjetheve, frutat e pjekura etj.:

a) _____

b) _____

c) _____

d) _____

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënë, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtrua për diskutim.

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?**, **Diskutoni**, **Provoje dhe ti**, **Punë në grup** dhe **Këshillë**.

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika **Si mendon?**

Vjeshta zakonisht mendohet si një stinë e trishtë për shkak se bien gjethet, ulen temperaturat etj. Në këtë poezi kushtuar vjeshtës pamë që autori ka një këndvështrim të ndryshëm, për të vjeshta mund të jetë po aq e gëzuar sa edhe stinët e tjera, sepse edhe ajo ka bukurinë e saj.

A pajtohesh edhe ti me këtë mendim? Argumento.

Diskutoni :

Cilat janë karakteristikat më të rëndësishme që ka secila nga stinët e vitit. Ndahuni në katër grupe dhe secili grup le të bëjë karakteristikat e secilës stinë. Cili grup ka shkruar më shumë karakteristika?

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës Detyrë shtëpie dhe që për këtë orë mësimore është:

Shkruaj një hartim me temë “Stina ime e parapëlqyer” dhe lexoje atë në klasë. Dëgjo me vëmendje edhe shokët/shoqet të cilët për këtë detyrë kanë zgjedhur të njëjtën stinë. Çfarë kishin shkruar më shumë ata për stinën e tyre të parapëlqyer. Po ti, çfarë të veçante kishe gjetur, që të tjerët nuk e kishin përmendur?

SHĚNIME:

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are approximately 20 lines visible. The paper has a slight shadow on the right side, suggesting it's resting on a surface.

E. Maqellara

GENTIANA

Tema mësimore: DUAJE EMRIN TËND

Titulli i temës: "Gentiana"

Autori i pjesës së përzgjedhur: E. Maqellara

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur tregimin, të dallojë personazhet dhe pjesët përbërëse të tij si dhe të mbërrijë të gjejë se cili është mesazhi i tij.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Gentiana"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *historia, ilirët, Genti, Gentiana, bimë, mësuesi etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Për çfarë ishte kureshtare të mësonte Gentiana?

Ku dhe kur kishte mbretëruar mbreti Gent?

Përveçse ishte mbret, çfarë studionte ai? Përse bima që ai kishte zbuluar ishte e rëndësishme?

Çfarë vendosi të bënte Gentiana pasi dëgjoi shpjegimin e mësuesit/mësueses?

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?, Diskutoni, Provoje dhe ti, Punë në grup dhe Këshillë.**

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika **Diskutoni:**

Diskutoni lidhur me emrat që kanë shokët dhe shoqet e klasës. Shkruajini të gjithë emrat në dërrasë dhe përpikuni t'i gruponi ata, p.sh. sa prej tyre janë me prejardhje shqiptare, sa prej tyre janë emra të trashëguar prej të parëve, sa janë emra të rinj etj.

Përpikuni të njihni kuptimin e secilit prej tyre.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Bëj kërkime për kuptimin e emrit tënd.

SHËNIME:

This image shows a single sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Etnografi, Histori, Gjuhë dhe komunikim

EJA ME MUA NË MUZE

Tema mësimore: PROJEKT

Titulli i temës: "EJA ME MUA NË MUZE"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Etnografi, Histori, Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Vëzhgim, dëgjim, shkrim, reportazh

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të dallojë artefaktet e ndryshme në muzé, periudhat të cilave ato u përkasin, teknologjinë e mbledhjes, katalogimit, sistemimit, ekspozimit dhe ruajtjes së objekteve muzeale si dhe të bëhet i vetdijshëm për rëndësinë e ruajtjes së kujtesës përmes muzeve.

Eja me mua në muzé

I dashur nxënës, sot kam vendosur që të të çoj në një muze të veçantë i cili është shumë afër shkollës sate, madje ai mund të jetë edhe afër shtëpisë satë.

Aty ti do të shohesh një shtëpi të vogël e cila është e mbudhur me historinë e të parëve të tu. Ajo shtëpi është frut i dashurisë dhe vetëdijes për vlerën që ka identiteti kombëtar.

MUZEU ETNOGRAFIK I MALËSISË

Muzeu Etnografik "Malësia" u hap në maj të viti 2002 nga Shtjefën Tomë Ivezaj. Për ata që janë më të rritur se ju në moshë, e kanë njohur Shtjefnin si fotografën e Malësisë (shumë e kanë quajtur "Marubi i Malësisë") i cili ishte i pranishëm në të gjitha rastet e familjeve malësore përmes fotove (autorja e këtij shkrimi ruan kujtime nga fëmijëria se si një herë në vit prindërit e çonin dhe i bënë foto në studion e tij përballë kishës). Pra dashuria e tij për artin dhe kulturën është e hershme dhe aq më shumë njohja e malësorëve me Shtjefnin.

Ai bashkë me bashkëshorten e vet vendosën që shtëpinë e tyre ta kthenin në Muzé. Për të gjithë në fillim ishte e çuditshme, madje disa edhe mund ta kenë quajtur çmenduri dëshirën e Shtjefnit.

Ai, ditë pas dite dhe për vite me radhë, i grumbulloi objektet muzeale nëpër të afërm dhe banorë të Malësisë. Sot, pas kaq vitesh, shtëpia e tij është e njohur edhe jashtë kufijve të Malit të Zi. Muzeu Etnografik "Malësia" nuk është më vetëm shtëpia e Shtjefnit, sepse çdo hapësirë e saj është kthyer në oaz të kulturës dhe traditës sonë.

Sot në Muzeun Etnografik "Malësia" gjenden seksionet e **filatelisë, galerisë, fototekës dhe bibliotekës**.

Ndër vite ky muze ka pritur vizitorë të shumtë nga të gjitha vendet e botës dhe të gjithë kanë mbetur të habitur nga sakrifica e çiftit Ivezaj.

Sapo të futesh në oborrin e Muzeut do të takohesh me "mërgimtarin malësor" i cili "ruan" shtëpinë; pastaj në korridor me librin e përshtypjeve; me bibliotekën; me dhomën e miqve, ku në mes të pret sofa dhe votra malësore, xhubleta, e plot objekte të tjera që janë pjesë e trashëgimisë tënde materiale dhe shpirtërore.

Muzeu është prova e sakrificës së madhe për kulturën dhe trashëgimia e të gjithë malësorëve. Aty jeton historia dhe bashkë me të edhe të parët tanë.

MËSO

Filateli - mbledhje pullash poste e pullash të tjera për koleksion

Filatelist - ai që mbledh pulla poste e pulla të tjera për koleksion

Fototekë - koleksion fotografish

Galeri - vend ku ruhen dhe ekspozohen vepra arti, objekte me vlerë

Muzé - institucion që mbledh, ruan e paraqet në ekspozita vepra e krijime të ndryshme të artit e të teknikës, sende, objekte e materiale me vlerë historike e shkencore

18 maji - Dita Ndërkombëtare e Muzeut

PROJEKT

- Shkruani një reportazh për vizitën në muze.
- Tregoni në klasë çfarë ju ka bërë përshtypje atje.
- Objektet që nuk i kishit parë.
- Kërkoni dhe shkruani për muzetë në Mal të Zi.

- Bëni kërkime rreth historikut të tyre.
- Çfarë karakteristikash kanë si muze?
- Çfarë rëndësie kanë këta dy muze për ty dhe vendin tënd?
- Shkruani një reportazh të shkurtër për të dy muzetë në Ulqin.

This image shows a blank sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Popullore

EDHE TI NUK E GJEN KËTË KOKË

Tema mësimore: ÇËSHTJE KOKE

Titulli i temës: “Edhe ti nuk e gjen këtë kokë”

Autori i pjesës së përzgjedhur: Popullore

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë pjesën me intonacionin e duhur dhe ta analizojë atë duke dalluar personazhet dhe motivin e përrallës.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: Çështje koke, “Edhe ti nuk e gjen këtë kokë”

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *tregtar, dyqan, kapuç, blerës, kokë etj.*

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:
 - Përse nuk i ishte shitur kapuçi tregtarit të madh?
 - Për çfarë arsye u gëzua blerësi me kokë të madhe?
 - Pse nuk ranë dakord tregtari dhe blerësi?
 - A jepet në tekst nëse blerësi me kokë të madhe e blen apo jo kapuçin?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Hapi III

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Pyet më të rriturit që të të tregojnë një anekdotë popullore. Për çfarë flet ajo? Shkruaje atë dhe tregojë në klasë me intonacionin e duhur.

SHËNIME:

Xhevahir Spahiu

VJESHTA

Tema mësimore: VJESHTA E ARTË

Titulli i temës: "Vjeshta"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Xhevahir Spahiu

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë poezinë me intonacionin e duhur, të gjejë figurat letrare, temën dhe motivin kryesor si dhe dhe ta recitojë vjershën përmendësh.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: **Vjeshta**

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për vjershën që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi i vjershës nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *vjeshta, vera, zogjtë, e artë, rrushi, njeriu etj.*

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Cilat janë shenjat që paralajmërojnë ardhjen e vjeshtës? Gjeji ato në poezi.

Cilat janë ngjyrat që autori përdor për të përshkruar vjeshtën?

A flet autori për vjeshtën me trishtim apo me gëzim? Ku shprehet ky gëzim?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

- b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin**, duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Përse autori përdor vargun, "Vjeshtë e artë, o stinë e zjarrtë", për të përshkruar vjeshtën?

Si e kupton ti këtë varg?

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë atyre të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?**, **Diskutoni**, **Provoje dhe ti**, **Punë në grup dhe Këshillë**.

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika **Diskutoni**:

Çfarë ndryshimesh pëson natyra gjatë stinës së vjeshtës? Po njeriu?

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Bëj një hartim me temë “Vjeshta në vendin tim”, ku të përshkruash se çfarë ndryshimesh ndodhin në vendin tënd kur vjen kjo stinë.

SHĚNIME:

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Mark Milani

MIKPRIJTJA

Tema mësimore: TË NJOHIM RRËNJËT TONA

Titulli i temës: "Mikpritja"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Mark Milani

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë pjesën dhe të mësojë rreth traditave shqiptare.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Mikpritja"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *mikpritja, shtëpia, fisi, udhëtarët, oda etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Cili është tipari më karakteristik i shqiptarëve?

Si e presin mikun shqiptarët?

A është mikpritja e shqiptarëve e lidhur me faktin se sa e pasur është familja që pret mysafirin?

Gjej në tekst pjesën që tregon këtë rast.

Kush konsiderohet "mysafir" nga shqiptarët?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?**, **Diskutoni**, **Provoje dhe ti**, **Punë në grup dhe Këshillë**.

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika **Të bisedojmë**:

A ju ka ndodhur që para këtij teksti të keni lexuar ndonjë shkrim tjetër i cili flet për mikpritjen shqiptare?

I cili autor është? Flisni për mënyrën sesi ky autor përshkruan mikpritjen shqiptare.

Cili është mendimi juaj për traditën e bukur shqiptare të mikpritjes?

A mendoni që sot ajo është njësoj si dikur? Si ka ndryshuar ajo?

Çfarë do të bënit ju për ta ruajtur këtë traditë?

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Shkruaj një hartim mbi traditat dhe zakonet karakteristike mbi mikpritjen në Malësi.

SHĚNIME:

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are approximately 20 lines visible. The paper has a slight shadow on its right side, suggesting it's resting on a surface.

Lusi Maud Montgomëri

HISTORIA E ANËS

Tema mësimore: NJIHU ME ANËN

Titulli i temës: "Historia e Anës"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Lusi Maud Montgomëri

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë tekstin në prozë dhe të analizojë atë sipas pjesëve të tij përbërëse (hyrje-zhvillim-mbyllje); nxënësi arrin të dallojë personazhet e tregimit dhe temën qendrore.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: Njihu me Anën, "Historia e Anës"

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autorja e re që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të kësaj autoreje si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose një prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *udhëtim, jetime, shtëpia e fëmijëve, flokëkuqe etj.*

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Cilat janë personazhet e këtij tregimi?
Cila është tema e shkrimit që sapo lexove?
Çfarë ke ndjerë gjatë leximit të këtij fragmenti?
Pse kishte vendosur Ana që ta shijonte atë udhëtim?
Cilat janë tiparet e karakterit të Anës?
Si mendon, përse i vinte keq Marilës për Anën?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

- b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet: Përshkruaj me fjalët e tua pjesët më të dhimbshme të rrëfimit të Anës.

Listo elementet autobiografike në tekst

Listo emrat dhe fjalët që të janë dukur të panjohura dhe të vështira për t'i shqiptuar dhe diskutoni të gjithë bashkë në klasë se pse?

- a.
b.
c.

Ismail Kadare

PORTRETI I SKËNDERBEUT

Tema mësimore: TË NJOHIM HERONJTË TANË

Titulli i temës: "Portreti i Skënderbeut"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Ismail Kadare

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë poezinë me intonacionin e duhur dhe të analizojë figurat letrare; ai njeh personazhin qendror të poezisë dhe kupton karakteristikat e përshkuara për të. Nxënësi lexon rrjedhshëm poezinë dhe e mëson përmendësh, për ta recituar, atë.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "**Portreti i Skënderbeut**"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *Gjergj, Skënderbe, emblemë, luftra, eshtra, Shqipëri, etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Si e përshkruan autori i kësaj poezie portretin e Skënderbeut?

Ky portret është vetëm fizik, apo autori përshkruan edhe elemente të karakterit luftarak të Skënderbeut?

Sa beteja bëri Skënderbeu përpara se të vdiste?

Çfarë ndodhi pas vdekjes së Skënderbeut me trupin e tij?

Cila ishte gjëja që Skënderbeu donte më shumë?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Gjej në tekst figurat letrare (krahasimet, metaforat) që përdoren për të përshkuar Skënderbeun: Skënderbeu ishte:

a) Si ditë e plotë

a) si dielli

Gjej në tekst vargjet apo shprehjet ku tregohet lufta heroike e Skënderbeut.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë atyre të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruarra për diskutim.

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Mund edhe të zgjedhësh të bësh portretin e një personazhi përrallash që ke lexuar në libra ose e ke parë në film. Portretin mund ta shkruash në poezi ose në prozë. Nëse të pëlqen të vizatosh, mundesh që këtë detyrë ta realizosh duke e vizatuar portretin që ke zgjedhur. Tregoje atë para shokëve dhe shoqeve të klasës.

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are approximately 20 lines visible. The paper has a slight shadow on the right side, suggesting it's resting on a surface.

Anton Berisha

MOTRA U NIS PËR RRUGË

Tema mësimore: MOTRA GUXIMTARE

Titulli i temës: "Motra u nis për rrugë"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Anton Berisha

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur përrallën, të dallojë personazhet, të analizojë pjesët përbërëse të saj, ta ritregojë me intonacionin e duhur dhe të gjejë moralin (porosinë) e saj.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "**Motra u nis për rrugë**"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *flaka, buburrecët, motra, mirënjohja, vëllezërit etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Ku zhvillohet ngjarja? (Rretho përgjigjen e saktë)

a. Në pyll

b. Në shtëpi

c. Afër lumit

Ku po shkonte motra që ishte nisur për rrugë?

Pse po qanin buburrecët?

a. Po mbyteshin

b. Po digjeshin

c. Kishin mbetur vetëm

Si ia shprehën mirënjohjen buburrecët vajzës?

Çfarë do të kishit bërë ju, nëse do të ishit në vendin e vajzës?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Nga sa kupton nga ky tekst dhe tekstet që ke bërë deri tani, sipas teje çfarë është **fragmenti**?

Si e kupton këtë shprehje: "Qanin aq shumë sa për t'i dhimbsur gurit e drunit." (Shkruaj me fjalët e tua.)

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë atyre të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruar për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?**, **Diskutoni**, **Provoje dhe ti**, **Punë në grup** dhe **Këshillë**.

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika **Punë në grup**:

Diskutoni në grup për rastet kur ju keni ndihmuar një person ose ndonjë krijesë e cila ka qenë në rrezik?

Përse e keni bërë?

Si jeni ndier pasi e keni shpëtuar?

A mendoni se njerëzit duhet të jenë më të kujdesshëm ndaj gjërave që ndodhin rreth tyre?

SHĚNIME:

This image shows a single sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Adelina Mamaqi

FISHEKZJARRËT

Tema mësimore: **ATMOSFERË FESTIVE**

Titulli i temës: "Fishekzjarrët"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Adelina Mamaqi

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë poezinë me intonacionin e duhur dhe të analizojë figurat letrare.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Fishekzjarrët"

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autorja e re që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të kësaj autoreje si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *fishekzjarrët, ngjyra, qiell, brohorima*.

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Çfarë atmosfere përcjell poezia?

Çfarë të kujtojnë fishekzjarrët?

Në sa strofa është e shkruar poezia?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

- b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

1. Shkruaj strofën që të pëlqen më shumë dhe interpretoje.

-
2. Provo të shkruash edhe ti një poezi për Fishekzjarrët

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruar për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?, Diskutoni, Provoje dhe ti, Punë në grup dhe Këshillë**.

A është i ligjshëm përdorimi i tyre?

A festohet Viti i Ri pa fishekzjarrë?

Shkruaj një hartim për atmosferën që krijojnë fishekzjarrët natën e Vitit të Ri.

This image shows a single sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Esad Mekuli

PËR GJUHË E SHKRIM

Tema mësimore: RËNDËSIA E GJUHËS

Titulli i temës: "Për gjuhë e shkrim"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Esad Mekuli

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë poezinë me intonacionin e duhur, të bëjë analizën e figurave letrare dhe të kuptojë rëndësinë që ka gjuha.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: **"Për gjuhë e shkrim"**

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *shkronja, armiku, amnore, sokol, prorre etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Kujt ia kushton autori këtë poezi?

Çfarë nuk kishte lënë në robëri armiku?

Cila është porosia që autori lë lidhur me gjuhën amtare?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Si kupton shprehjen "vargonj të zinj"?

Përse mendon se autori e ka zgjedhur këtë shprehje?

Si kupton shprehjen "e kaluara u shemb"? Për cilën të kaluar e ka fjalën autori?

Autori e nis poezinë me kohën e shkuar (**rob ishëm**) dhe e mbyll me të tashmen dhe duke iu drejtuar së ardhmes (**je i lirë sot e prorre**). Për kë e ka fjalën autori? Kush ishte dikur në robëri dhe sot është i lirë?

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënë, duke

Popullore

TRE QETË DHE UJKU

Tema mësimore: MIQTË NUK HIDHEN POSHTË

Titulli i temës: “Tre qetë dhe ujku”

Autori i pjesës së përzgjedhur: Popullore

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë fabulën, të dallojë personazhet dhe të kuptojë mesazhin alegorik të saj.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: “Tre qetë dhe ujku”

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, çfarë do të trajtohet dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kye: *qetë, ujku, uria, bora, dimri, mashtrim etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Çfarë përpiquej të bënte ujku me tre qetë?

Si e mashtroi ai kaun e parë? Cilat ishin fjalët që përdori?

Si e mashtroi ai kaun e dytë? Cilat ishin fjalët që përdori?

Si e mashtroi ai kaun e tretë? Cilat ishin fjalët që përdori?

Cili qe fati i tre qeve?

Sipas mendimit tënd, cili është morali i kësaj fabule?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Diskutoni në klasë rreth mesazhit që kjo fabul përcjell.

Si mendoni, përse janë të rëndësishme fabulat? Çfarë mësojmë ne prej tyre?

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiquej të përfshijë sa më shumë nxënësit, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruar për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore, përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Sill raste fabulash të tjera që njeh dhe që kanë një moral të ngjashëm me këtë që sapo lexuat. Tregoji ato në klasë.

SHËNIME:

This image shows a single sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Moris Karen

MIRËSI

Tema mësimore: NJË KËSHILLË ME VLERË

Titulli i temës: "Mirësi"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Moris Karen

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë poezinë me intonacionin e duhur dhe të kuptojë mesazhin e saj.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: **"Mirësi"**

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: mollë, kanistër, pemë, lumturi etj.

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Cila është tema e kësaj poezie? Për çfarë flet ajo?

Çfarë nuk mjafton për autorin?

Çfarë ndrit për të, në fund të poezisë?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon? Diskutoni, Provoje dhe ti, Punë në grup dhe Këshillë.**

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika **Diskutoni:**

Si e kuptoni ju mirësinë?

Pse është e rëndësishme ajo në jetë?

Diskutoni me njëri-tjetrin në klasë se si mund të përhapet mirësia midis njerëzve.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Shkruaj përshtypjet e tua për ndonjë rast ku ke qenë i pranishëm në një situatë kur dikush ka bërë një akt (veprim) mirësie për një njeri, kafshë apo për natyrën. Si je ndier? Ke dashur edhe ti të bëheshe pjesë e atij akti mirësie? Çfarë veprimi mirësie mendon të bësh edhe ti në të ardhmen? Shpjego pse?

This image shows a single sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Popullore

MOS HARRO - DATA TË RËNDËSISHME

Tema mësimore: PROJEKT

Titulli i temës: "MOS HARRO - DATA TË RËNDËSISHME"

Lidhja me fushat e tjera: Histori, Etnografi, Kulturë,

Metodologjia dhe veprimtaritë: Vëzhgim, dëgjim, shkrim, reportazh

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të dijë datat e rëndësishme ndërkombëtare, rëndësinë, kuptimin e tyre dhe mënyrën se si përkujtohen ato.

MOS HARRO - DATA TË RËNDËSISHME

2 Prilli - Dita Ndërkombëtare e Librit për Fëmijë

Që prej vitit 1967, më 2 prill, në ditën e lindjes së Hans Kristian Andersenit, festohet Dita Ndërkombëtare e Librit për Fëmijë, për të frymëzuar dashurinë për leximin dhe për të tërhequr vëmendjen e fëmijëve tek librat.

23 Prilli - Dita ndërkombëtare e Librit dhe e të drejtave të autorit.

Kjo datë shënohet në botë që nga viti 2003, ndërsa është vendosur në vitin 1995, me qëllim që të kontribuojë në mbarë botën për të drejtat e autorit, duke inkurajuar të gjithë, e në veçanti të rinjtë, për të zbuluar kënaqësinë e leximit. Kjo është një datë me kuptim simbolik për letërsinë botërore. Me këtë datë, të vitit 1616, lidhet vdekja e dy kolosëve të letërsisë botërore: Shekspirit në Angli dhe Miguel de Servantesit në Spanjë. Shekspiri konsiderohet si shkrimtari më i madh i të gjitha kohërave dhe vendeve, ndërsa Miguel de Servantes është autori i veprës më të përkthyer në botë, "Don Kishoti i Mançës".

1 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve

Dita e fëmijëve u vendos në datën 1 qershor, sepse në këtë datë është mbajtur Konferenca Botërore e Mirëqënies së Fëmijëve, në Gjenevë, në vitin 1925.

Dy vjet më pas, Festa e 1 Qershorit filloi të festohet në të gjithë botën.

5 Qershori - Dita Botërore e Mjedisit

Data 5 qershor u zgjodh si Dita Botërore e Mjedisit në vitin 1972, nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.

Kjo datë u zgjodh sepse përkon me ditën e hapjes e Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin, që u mbajt në vitin 1972 në Stokholm, nën udhëheqjen e Programit Mjedisor të Kombeve të Bashkuara.

Qëllimi i kësaj ngjarjeje është të nxisë aktivitete për të arritur ndryshime pozitive në mbrojtjen e mjedisit. Kjo ditë zakonisht përcillet me një tematikë të caktuar.

Në të kaluarën tema të kësaj ngjarje kanë qenë kujdesi për tokën dhe ujin, mbrojtja e shtresës së ozonit, ndryshimet klimatike dhe zhvillimi i qëndrueshëm, duke pasur gjithnjë në qendër ruajtjen e shëndetit.

Punë në grup

- Ndahuni në katër grupe dhe për një javë punoni për të gjetur data të tjera të rëndësishme ndërkombëtare.
- Shkruani se cilat nga datat ndërkombëtare të gjetura festohen në vendin tuaj.
- Gjeni dhe shkruani datat kombëtare që festohen në vendin tuaj.

SHËNIME:

[illegible]

Zef Gjuraravçaj

MALËSORES

Tema mësimore: NJË PORTRET FISNIK

Titulli i temës: "Malësoret"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Zef Gjuraravçaj

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë poezinë me intonacionin e duhur, të gjejë figurat letrare, ta mësojë përmendësh dhe ta recitojë atë.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Malësoret"

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *malësore, belhollë, ndera, besa, sokol, kurorë etj.*

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Si e përshkruan autori malësoren? Si është ajo në sytë e tij?

A është portreti i malësore me shumë fizik apo moral/shpirtëror?

Cila është porositja që autori i poezisë i jep në fund malësore?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

- b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Gjej në tekst shprehjet dhe figurat letrare të cilat përdor autori për të përshkruar femrën malësore.

Shkruaji ato :

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiqet të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtrura për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që bën nxënësi në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Gjej foto ose skica të gruas malësore dhe silli ato në klasë. Kush ka gjetur materialin më interesant?

Gjej krijime të tjera që flasin për gruan apo për burrin malësor dhe silli për t'i lexuar ato në klasë.

This image shows a full page of blank, lined paper. It features approximately 20 evenly spaced horizontal grey lines across its entire width, providing a template for handwriting practice or general note-taking. The margins are consistent on all sides.

Populli

FJALËT E URTA DHE GJËEGJËZAT

Tema mësimore: MENÇURIA E POPULLIT

Titulli i temës: "Fjalët e urta dhe gjëegjëzat"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Populli

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje ta njohë krijimtarinë popullore dhe të diskutojë rreth fjalëve të urta si edhe të zgjidhë gjëegjëzat e dhëna në tekst.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Fjalët e urta dhe gjëegjëzat"

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, çfarë që do të trajtohet dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *fjalë të urta, gjëegjëza*

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Cila nga fjalët e urta të pëlqeu më shumë? Pse?

Cila nga gjëegjëzat ishte më e lehta? Po më e vështira? Pse?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?**, **Diskutoni**, **Provoje dhe ti**, **Punë në grup dhe Këshillë**.

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika **Si mendon**:

Përse duhet që t'i mësojmë fjalë të urta? Për çfarë na shërbejnë ato?

Po gjëegjëzat, përveçse janë argëtuese kur i tregojmë me njëri-tjetrin, për çfarë na ndihmojnë?

Diskutoni:

Tregimi i gjëegjëzave, po ashtu si edhe tregimi i përrallave, lojrat e ndryshme apo leximi i librave, dikur kanë qenë format më të zakonshme të argëtimit, por edhe të mësimit njëkohësisht. Sot duket se teknologjia po e zëvendëson këtë mënyrë argëtimi. Si mendoni ju, cilat janë anët e pozitive dhe negative të teknologjisë në mënyrën sesi ajo po bëhet pjesë e së përditshmes suaj. Argumentoni përgjigjet tuaja.

Provoje dhe ti:

Përpiqu të gjesh një gjëegjëzë të vështirë dhe tregojë atë në në klasë. Kush tregoi më të vështirën?

Hapi IV

Kërkoju prindërve të të tregojnë pesë fjalë të urta dhe pesë gjëgjëza të reja, që nuk janë në këtë mësim. Shkruaji ato dhe tregoji në klasë.

[illegible]

Migjeni

LULI I VOCËRR

Tema mësimore: SHOKU YT, LULI

Titulli i temës: "Luli i vocërr"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Migjeni

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje ta lexojë tregimin, ta kuptojë portretizimin fizik dhe shpirtëror të Lulit të vocërr dhe është në gjendje ta interpretojë pjesën.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Luli i vocërr"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kye: *nxënës, i ftohtë, mësuesi/mësuesja, tollumbat etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

A keni dëgjuar apo lexuar më parë për Migjenin?

Kush është personazhi kryesor në tekstin që sapo lexuat?

Luli

Mësuesi/mësuesja

Shokët

Pse Luli ka dëshirë që t'i dhurojë diçka mësuesit:

Sepse të gjithë nxënësit i bëjnë dhurata mësuesit?

Sepse e do mësuesin?

Mësuesi është i vetmi që i afrohet dhe e ledhaton Lulin?

Cilës gjini letrare i përket "Luli i vocërr"

Poezi

Tregim

Dramë

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet: Shkëput dy fjali që të kanë prekur më shumë nga teksti dhe shpjego me fjalët tua pse:

a) _____

b) _____

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiqet të përfshijë sa më shumë pjesëmarrje nga ana e nxënësve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

1. Pasi sot në klasë ke lexuar tregimin e shkurtër “Luli i vocërr” shkruaj me fjalët e tua atë që ke kuptuar nga teksti:
2. Përshkruaje personazhin Luli i vocërr, sipas pamjes fizike dhe cilësive të karakterit?

This image shows a single sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Edmond Daliu

VËLLA E MOTËR

Tema mësimore: TEATRI I KLASËS

Titulli i temës: "Vëlla e Motër"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Edmond Daliu

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë/interpretojë, në bashkëpunim me shokët dhe shoqet e klasës skenën, e kupton sesi funksionon koncepti i teatrit dhe lojës skenike.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Vëlla e Motër"

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *vëlla, motër, ëmbëlsirë, grykës, pendim, falje etj.*

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Përse u vonua Artani në shkollë?

Po Linda ku kishte shkuar që në mëngjes?

Përse nëna e Artanit nuk kishte blerë fruta?

Çfarë porosish i lë nëna Artanit para se të dalë nga shtëpia për të shkuar në punë? Ai zbaton ai porosinë e nënës?

Çfarë i sjell Linda Artanit pasi kthehet nga teze Liria? Pse Artani refuzon ta marrë?

Si reagon Linda kur Artani i tregon që ai ka ngrënë edhe pjesën e saj të ëmbëlsirës?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

- b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Gjeni pjesën në tekst ku Artani tregohet i paduruar dhe ha edhe pjesën e ëmbëlsirës që nëna e kishte ruajtur për Lindën. Si mendoni se është sjellja e tij:

a) altruiste

b) egoiste

Shpjego.

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë nxënësve të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika **Si mendon:**

Në rastet kur dikush ka kryer diçka të gabuar, është më mirë që ai person të tregojë gabimin e vet dhe të kërkojë falje për të apo duhet të përpiqet që ta fshehë atë gabim në mënyrë që të mos e zbulojë askush?

Ti vetë, ke pasur ndonjë rast të ngjashëm kur ke gabuar dhe të është dashur të tregosh të vërtetën? Si ke vepruar? Je ndier më mirë pasi ke treguar të vërtetën?

Ndahuni në grupe me nga tre persona dhe përpikuni të luani këtë skenë të vogël ku secili prej jush të marrë përsipër të luajë një nga personazhet, nënën, Artanin ose Lindën.

Nëse nuk zgjidhni dot ose nuk bini dot dakord se cilin personazh do të luani, kërkonti ndihmën e mësuesit/mësueses për t'ju caktuar rolet.

Në fund, pasi keni luajtur skenën diskutoni me njëri-tjetrin në klasë se si ishte përvoja juaj e re si "aktorë". Cilat ishin vështirësitë që hasët, p.sh. mbajtja mend e tekstit, zgjedhja e shprehjes së duhur të fytyrës (mimikës) në situata të caktuara, intonacioni etj.

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe për këtë orë mësimore është:

Provo të shkruash edhe ti një skenar të vogël si ai që lexove në këtë mësim. Mund të përdorësh fare mirë situata nga shkolla, situata familjare, situata në marrëdhënie me shokët dhe shoqet e tua. Mbjaj mend që e rëndësishme është që në këto situata që do të zgjedhësh për këtë detyrë duhet të ketë një konflikt, sado të vogël, mes personazheve dhe se ky konflikt duhet zgjidhur, pikërisht ashtu si në rastin e Artanit me Lindën.

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are approximately 20 lines visible. The paper has a slight shadow on the right side, suggesting it's resting on a surface. There is no handwriting or other markings on the paper.

Nol Berisha

VALLJA E PRANVERËS

Tema mësimore: PRANVERA ERDHI

Titulli i temës: “Vallja e pranverës”

Autori i pjesës së përzgjedhur: Nol Berisha

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë poezinë me intonacionin e duhur, të analizojë figuracionin e poezisë, ta mësojë përmendësh dhe ta recitojë atë.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: “Vallja e pranverës”

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kye: *stina, blerimi, barinjtë, qengjat, pranvera etj.*

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Çfarë u kërkon autori fëmijëve që të bëjnë për shkak të ardhjes së pranverës?

Si është atmosfera pranverore në këtë poezi (mendo për ngjyrat dhe tingujt që autori ka përkthyer).

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

- b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

1. Si e kupton shprehjen “dimri shtegtoi”?

2. Poeti thotë “ngazllehen baria”. Çfarë kuptimi ka kjo shprehje? Përse ngazellehen barinjtë kur vjen pranvera? Çfarë do të thotë ardhja e pranverës për ta?

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruar për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund

Mark Tuen

PRINCI DHE I VARFRI

Tema mësimore: PRINC PËR NJË DITË

Titulli i temës: "Princi dhe i varfri"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Mark Tuen

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë fragmentin, të dallojë pjesët përbërëse të tij; të dallojë personazhet dhe të analizojë sjelljet e tyre duke mbajtur qëndrim kritik.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Princi dhe i varfri"

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *i varfër, djalë, princ, mbret etj.*

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Në cilin shekull lindën Tomi dhe Eduardi?

Përse për lindjen e Tomit nuk u gëzua akush? Po për Eduardin, pse u gëzuan të gjithë?

Në cilën datë po mbahej parada?

Cili ishte veprimi që bëri Tomi gjatë paradës kur pa nënën e tij dhe që bëri që e ëma ta njihte se ai nuk ishte princ Eduardi, por djali i saj?

Përse Tomi nuk ishte i lumtur?

Çfarë po të ndodhte në Pallatin Uestminster?

Në cilin moment të ceremonisë së kurorëzimit hyn Eduardi? Çfarë i ndodh atij nga njerëzit e pranishëm në ceremoni?

Çfarë pyetjesh i bën Lordi Protektor Eduardit për të provuar që ky i fundit ishte vërtet princi?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

- b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Me cilat fjalë i drejtohet nëna Tomit, i cili ishte veshur me rrobat e princit Eduard dhe po parakalonte para popullit. Gjeni ato fjalë në tekst dhe nënvizoj.

Përse Tomi nuk po arrinte t'i buzëqeshte turmës së njerëzve. Rilexoni edhe një herë atë pjesë të tekstit ku tregohet ky moment dhe dhe përshkruani me fjalët tuaja gjendjen shpirtërore të Tomit.

Popullore

BARESHA, GJYSHI DHE I DITURI

Tema mësimore: FUQIA E MENÇURISË

Titulli i temës: "Baresha, gjyshi dhe i dituri"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Popullore

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë përrallën, të njohë personazhet dhe atmosferën fantastike dhe të kuptojë alegorinë e saj, duke nxjerrë edhe porosinë (mesazhin) e përrallës.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "**Baresha, gjyshi dhe i dituri**"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, që do të trajtohet dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *baresha, gjyshi, malësia, bagëti, udhëtari, sundimtari etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Cilët janë personazhet e kësaj përralle?

Çfarë i kishte ndodhur gjyshit gjatë rrugës së kthimit për në shtëpi. Kë kishte takuar ai?

Si i ishte dukur gjyshit njeriu i çuditshëm që kishte takuar gjatë rrugës?

Përse u gëzua burri misterioz që takoi gjyshin në rrugë?

Cilat qenë pyetjet që njeriu i çuditshëm i bëri gjyshit? A i kuptoi gjyshi pyetjet e burrit në mënyrën e duhur apo jo? Po baresha?

Cila është pyetja që vajza (baresha) i kërkon gjyshit që t'i bëjë burrit të çuditshëm?

Përse burri ishte detyruar të udhëtonte? Çfarë ishte duke kërkuar ai?

Si e gjeti vajza zgjidhjen për burrin?

Cili është morali i kësaj përralle?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Gjej në tekst ato pjesë ku tregohet inteligjenca e vajzës:

Cilat janë shprehjet me të cilat nis dhe mbyllet zakonisht një përrallë. Shkruaj disa raste të këtyre shprehjeve.

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Rexhep Hoxha

RRITU, VENDI IM

Tema mësimore: TË DUAM VENDIN TONË

Titulli i temës: "Rritu, vendi im"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Rexhep Hoxha

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë poezinë me intonacionin e duhur, të njohë figurat dhe të analizojë poezinë.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Rritu, vendi im"

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *vendi im, brigje, fusha, gra trimnesha, pranverë etj.*

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Kujt ia kushton autori këtë poezi?

Si e përshkruan ai atdheun e vet? Si është atdheu për të?

Çfarë karakteristike kanë burrat dhe gratë në këtë poezi? Si portretizohen ata nga autori?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

- b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

1. Gjej në tekst dhe shkruaj rastet kur autori përdor figurën letrare të enumeracionit.

2. Gjej në tekst dhe shkruaj rastet kur autori përdor figurën letrare të epitetit.

3. Gjej në tekst dhe shkruaj rastet kur autori përdor figurën letrare të krahasimit.

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënë, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruar për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?**, **Diskutoni**, **Provoje dhe ti**, **Punë në grup** dhe **Këshillë**.

Për këtë orë mësimore parashikohet **Diskutoni:**

Cili është mendimi juaj për vendin ku jetoni?

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Bëj një krijim të shkurtër (në poezi ose prozë) me titull “Të mirat e vendit tim”.

SHËNIME:

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Tuni Papuçiu

NJË GËRVISHTJE E LEHTË

Tema mësimore: PAKUJDESITË E VOGLA

Titulli i temës: "Një gërvishtje e lehtë"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Tuni Papuçiu

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur tregimin, të dallojë personazhet dhe të kuptojë mesazhin e pjesës.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Një gërvishtje e lehtë"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *mjek, spital, sëmurë, plagë, fasha, mikrobe etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Babai i kujt ishte mjek?

Përse iu luten fëmijët babait të Orionit që të futeshin në spital? Kush ishte shtruar atje?

Çfarë i sollën shokët Taulantit për vizitë në spital?

Çfarë gabimi kishte bërë Taulanti që kishte përfunduar në spital?

Çfarë porositë u jep fëmijëve mjeku?

Çfarë u tregon ai atyre?

Si e zbatoi Taulanti këshillën e mjekut?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin**, duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Orioni e pyet babain se pse iu enjt këmba aq shumë Taulantit. I ati ia shpjegon arsyet dhe procesin se si ndodh infektimi. Tregojë edhe ti me fjalët e tua këtë proces.

Kutia e ndihmës së shpejtë që Taulanti kishte bërë, pas daljes nga spitali, përmbante:

a) _____

b) _____

c) _____

d) _____

e) _____

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpqet të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të jetë punë individuale që nxënësi bën në mënyrë të pavarur dhe ku mund të kërkojë asistencën e mësuesit/mësueses, por që nxitet të kërkojë ta përmbushë një detyrë të caktuar në mënyrë sa më të pavarur.

Rubrikat e përfshira në këtë hap mund të realizohen në klasë ose jashtë saj dhe ato përfshijnë rubrikat **Si mendon?**, **Diskutoni**, **Provoje dhe ti**, **Punë në grup dhe Këshillë**.

Për këtë orë mësimore parashikohet rubrika **Si mendon?**

Ka ndonjë veprim që ti e bën rregullisht dhe që mendon që nuk është higjenik ose i pashëndetshëm dhe që duhet të mos e bësh më?

Si mendon ta zgjidhësh?

Diskutoni:

Rëndësia e ruajtjes së higjenës për mbrojtjen e shëndetit.

Punë në grup:

A keni kuti të ndihmës së shpejtë në klasën tuaj? Nëse jo, provoni edhe ju, siç bëri Taulanti, që të krijoni një të tillë. Çfarë pajisjesh dhe barnash do ju duhen për ta krijuar atë? Bëni një listë të tyre dhe secili prej jush le të gjejë atë që i duhet. Në fund vendoseni kutinë e ndihmës së shpejtë në një pozicion të dukshëm në klasë.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Ka ndodhur ndonjëherë që ndonjë shoku\shoqja juaj të ketë munguar në shkollë për shkak se ka qenë i/e sëmurë? Keni shkuar ta vizitoni në spital ose në shtëpi? Po lidhur me shkollën, si e keni ndihmuar që të mos mbetej pas me mësimet? Shkruaje këtë përvojë si një hartim të shkurtër.

SHËNIME:

Hajro Ulqinaku

NË BREGUN E PULËBARDHAVE

Tema mësimore: AVENTURË VERORE

Titulli i temës: "Në Bregun e Pulëbardhave"

Autori i pjesës së përzgjedhur: Hajro Ulqinaku

Burimet: Teksti bazë

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur pjesën në prozë, të dallojë përshkrimin nga rrëfimi dhe ta ritregojë ngjarjen me fjalët e veta.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: "Në bregun e pulëbardhave"

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *breg, pulëbardha, shokë, liman, peshkim, det etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja çel rubrikën **Të kuptojmë tekstin** dhe u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

Cilët janë personazhet e këtij tregimi? Cila ishte dëshira e tyre?

Cfarë propozimi bëri Beni? A e pranuan propozimin e tij edhe dy shokët e tjerë?

Cili qe propozimi i Mirit? Në ç'mënyrë shkuan tre shokët deri te Bregu i Pulëbardhave?

Pasi u larguan nga Bregu i Pulëbardhave, ku shkuan tre shokët?

Kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

b) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Të analizojmë tekstin**, duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

Cilat ishin pajimet për peshkim që tre shokët morën me vete? Shkruaji ato:

a) pendët e notimit

b) _____

c) _____

d) _____

2. Cilat ishin vendet ku shkuan Beni, Miri dhe Edi?

a) Limani i vogël

b) _____

c) _____

3. Sa ishte numri i secilit prej gjahut të kapur prej tre shokëve?

a) _____ yje

b) _____ guaska

- e) _____gaforre

4. Çfarë lloj tregimi është ky:

- b) historik b) mitik c) adventuresk

Shpjego zgjedhjen që bëre.

Edhe kjo rubrikë zhvillohet në klasë.

Në të dyja rubrikat e **Hapit II** mësuesi/mësuesja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënës, duke u dhënë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre lidhur me pyetjet dhe çështjet e shtruara për diskutim.

Hapi III

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë shtëpie** dhe që për këtë orë mësimore është:

Shkruaj për një libër me aventura që ke lexuar. A të ka pëlqyer? Pse?

Ke kaluar edhe ti ndonjë aventurë gjatë pushimeve verore me shokët/shoqet? Nëse po, shkruaje dhe tregojë atë në klasë.

SHĚNIME:

This image shows a single sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

NGA DITARI I LEXIMEVE

Mitrush Kuteli

LIBRAT

Tema mësimore: MIQTË E MI TË VJETËR

Titulli i temës: “Librat”

Autori i pjesës së përzgjedhur: Mitrush Kuteli

Burimet: Ditari i Leximeve

Lidhja me fushat e tjera: Bibliotekonomi

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, katalogim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e teksteve, krijon bibliotekë personale

Rezultatet e arritura: Nxënësi gjen librat për të lexuar në bibliotekën e shkollës dhe i katalogon ata.

Hapi I:

- a) Shpjegohet tema dhe udhëzohen nxënësit se si dhe ku mund t'i gjejnë librat që duan të lexojnë jashtë detyrimeve të shkollës.
- b) Pyeten nxënësit për autorët që ata i pëlqejnë dhe kanë lexuar deri tani.
- c) U shpjegohet se sa e rëndësishme është mbajtja e shënimeve dhe katalogimi i librave.

Hapi II.

Mësuesi/mësuesja u shpjegon nxënësve tabelën, që do ta plotësojnë gjatë vitit shkollor. Sipas tabelës së mëposhtme plotësoji të gjitha gjatë vitit shkollor, me titujt që ke tani në këndin tënd të librave në shtëpi dhe me librat e rinj që do të lexosh ose blesh gjatë këtij viti.

Nr.	1
Autori	Mitrush Kuteli
Titulli	Tregime të moçme shqiptare
Vendi i botimit	Tiranë
Viti i botimit	2015
Shtëpia botuese	Botimet Kuteli
Pasazhi/shprehja e parapëlqyer	“Ata e marrin nusen e vogël dhe e murojnë në themel të kështjellës. Dhe muret ngrihen, lartohen, nuk shemben më si më parë. Po rrëzë tyre gurët janë edhe sot të lagët e të myshkët, sepse vazhdojnë të pikojnë lotët e nënës për birin e saj... Dhe i biri u rrit, luftoi e trimëroi.”

Hapi II

Mësuesi/mësuesja i sqaron nxënësit se kjo tabelë mund të plotësohet edhe me librat që i kanë me detyrim në lëndën e letërsisë gjatë vitit shkollor ose me libra që i lexojnë jashtë detyrimeve shkollore.

Mësuesi/mësuesja i vë në dijeni që në fund të vitit do t'i kontrollojë tabelat nëse janë plotësuar.

MIQTË E MI TË RINJ

Rezultatet e arritura: Nxënësi di të gjejë librat e rinj për të lexuar, kërkon, mban shënime, rrit numrin e autorëve që njeh.

c) U shpjegohet se sa e rëndësishme është mbajtja e shënimeve dhe përmbajtja e librave që lexojnë.

This image shows a single sheet of white paper with horizontal blue or grey ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are approximately 20 lines visible. The paper has a slight shadow on its right side, suggesting it's resting on a surface.

Sami Frashëri

DHE U ËSHTË FLORI

Titulli i temës: “Dheu është flori”

Autori i pjesës së përzgjedhur: Sami Frashëri

Burimet: Ditari i leximeve

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur pjesën në prozë, të dallojë përshkrimin nga rrëfimi dhe ta ritregojë ngjarjen me fjalët e veta.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: **Dheu është flori - Sami Frashëri**

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *dheu, flori, bujk, stamna, flarinj etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Pasi lexove duke** u drejtuar nxënësve pyetjet:

Si e kupton t’i shprehjen “Dheu është flori”?

Bëhet fjalë për kuptimin e parë të fjalës apo ka diçka më shumë se kaq?

Përse plaku nuk u tregoi që në fillim djemve atë që kishte ndërmend?

Çfarë kërkoi prej tyre?

Shkëpute nga teksti pjesën që të pëlqen më shumë dhe komentoje.

Cili është morali i kësaj përrallë?

Pse duhet ta duam tokën dhe punën?

Hapi III mësuesi/mësuesja përpiqet që të nxisë nxënësit për të provuar veten si shkrimtarë:

PROVOJE VETEN

“Unë shkrimtari”

Provo të shkruash vetë një përrallë për rëndësinë e tokës/punës ose një temë tjetër lidhur me rëndësinë e punës.

Hapi IV

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detjërë** dhe që për këtë orë mësimore është:

Gjej shprehje popullore të cilat flasin për rëndësinë e punës dhe të tokës.

Ezopi

FABULA NGA EZOPI

Titulli i temës: "Fabula nga Ezopi

Autori i pjesës së përzgjedhur: Ezopi

Burimet: Ditari i leximeve

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të njohë fabulën, dallon personazhet e saj dhe është në gjendje të nxjerrë porosinë e secilës prej fabulave të Ezopit.

Hapi I:

- a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: **Fabula nga Ezopi**

- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i disa fabulave që janë në Ditarin e Leximeve.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura.

Hapi II.

- a) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Pasi lexove**, duke u drejtuar nxënësve pyetjet që kanë për secilën fabul (shih te Libri i Nxënësit).

Hapi III

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë** duke përfshirë të gjitha fabulat që janë në tekstin **Libri i Nxënësit**.

Hans Kristian Andersen

SHITËSJA E VOGËL E SHKREPËSEVE

Titulli i temës: “Shitësja e vogël e shkrepëseve”

Autori i pjesës së përzgjedhur: Hans Kristian Andersen

Burimet: Ditari i Leximeve

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur përrallën, ai dallon personazhet e saj, dallon përshkrimin nga rrëfimi dhe është në gjendje të ritregojë ngjarjen me fjalët e veta.

Hapi I:

a) Shkruhet fillimisht tema mësimore në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin.

Tema: Shitësja e vogël e shkrepëseve - H. K. Andresen

b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet dhe disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.

c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.

d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.

e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetje që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.

f) Shkruhen në tabelë fjalët kyçe: *shitësja e vogël, shkrepëse, gjyshja etj.*

Hapi II.

a) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Pasi lexove** duke u drejtuar nxënësve pyetjet:

1. Përse shitësja e vogël e shkrepëseve nuk donte të kthehej në shtëpi? Nga se kishte frikë ajo?

2. Për cilën periudhë të vitit bën fjalë përralla?

3. Çfarë pa vajza pasi fërkoi shkrepësen e parë?

4. Po kur fërkoi shkrepësen e dytë?

5. Po kur fërkoi shkrepësen e tretë? Po të katërtën?

6. Për cilën arsye e fërkoi ajo të gjithë tufën e shkrepëseve?

7. Cila ishte pamja më e dashur që vajza pa atë natë?

8. Si mbyllet përralla? A mendon që kujtimi i gjyshes ia lehtësoi sadopak vuajtjen shitëses së vogël të shkrepëseve?

9. Çfarë ndjeve ti kur lexove këtë përrallë?

Hapit III

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës Detyrë dhe që për këtë orë mësimore është:

1. Me siguri që të ka ndodhur të shohësh fëmijë të moshës sate të cilët janë të varfër dhe që kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje. Pasi ke lexuar një përrallë kaq të dhimbshme si kjo, si mendon ta ndihmosh një fëmijë të tillë? A do ta kërkoje edhe ndihmën e prindërve ose të shokëve dhe shoqeve për ta realizuar këtë ide?

Shkruaj mendimet e tua në formën e një projekti për të ndihmuar fëmijët në nevojë.

Viktor Canosinaj

QENI MILIONER

Titulli i temës: “Qeni milioner”

Autori i pjesës së përzgjedhur: Viktor Canosinaj

Burimet: Ditari i Leximeve

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur pjesën në prozë, dallon personazhet, përshkrimin nga rrëfimi dhe është në gjendje ta ritregojë ngjarjen me fjalët e veta.

Hapi I

- a) Shkruhet fillimisht tema në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin. Tema: **Qeni milioner - e autorit** Viktor Canosinaj
- b) Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autori i ri që do të trajtohet, disa karakteristika krijuese të këtij autori si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- c) Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga ndonjë prej nxënësve i pjesës së leximit.
- d) Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- e) Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetjet që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- f) Shkruhen në tabelë fjalët kyç: *qeni, plaku, Topi prej Bore, djali etj.*

Hapi II

- a) Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Pasi lexove**, duke u drejtuar nxënësve pyetjet:
 1. Cilët janë personazhet e këtij tregimi?
 2. A ke simpati ti për Topin prej Dëbore? Çfarë sjelljeje ka ai që të bën ta duash dhe simpatizosh si personazh?
 3. Çfarë përpiqet të bëjë Topi prej Dëbore? Si kërkon ai të ndryshojë jetesën e botës së kafshëve?
 4. A mendon se kjo botë e kafshëve, e cila është e përshkruar në këtë tregim si edhe qëllimet fisnike që kishte Topi prej Dëbore mund të na vlejné edhe ne në botën njerëzore si shembull për t’u ndjekur?

Arsyeto.

Hapi III

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës Detyrë dhe që për këtë orë mësimore është:

1. Shkruaj një hartim me temë “Po të isha unë milioner”.

Bllaga Zhuriq

NË MBRETËRINË E SHKRONJAVE

Titulli i temës: “Në mbretërinë e shkronjave”

Autori i pjesës së përzgjedhur: Bllaga Zhuriq

Burimet: Ditari i Leximeve

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhë dhe komunikim

Metodologjia dhe veprimtaritë: Lexim, vëzhgim, dëgjim, shkrim

Kompetenca e fituar nga nxënësi: Lexim, analizë e tekstit, shkrim krijues

Rezultatet e arritura: Nxënësi është në gjendje të lexojë me intonacionin e duhur pjesët në prozë të pjesës së dhënë, dallon personazhet, dallon përshkrimin nga rrëfimi dhe është në gjendje të ritregojë ngjarjen me fjalët e veta.

Hapi I

- Shkruhet fillimisht tema në tabelë, sepse e përqëndron më shumë nxënësin. Tema: **Në mbretërinë e shkronjave**-Bllaga Zhuriq
- Shpjegohet paraprakisht se cila do të jetë tema, autorja e re që do të trajtohet, disa karakteristika krijuese të saj si dhe një sqarim i përgjithshëm për materialin që do të lexohet.
- Bëhet leximi nga mësuesi/mësuesja ose nga një prej nxënësve i pjesës së leximit.
- Pas përfundimit të leximit, pyeten nxënësit për fjalët e panjohura, pa u lexuar ende fjalorthi.
- Lexohet fjalorthi nga nxënësit dhe jepen sqarime shtesë për pyetjet që mund të kenë nxënësit për fjalët e reja.
- Shkruhen në tabelë fjalët kyç: *shkronja, Toka e Harruar, Shpirtëligu, Neda, Ujkani, magjia etj.*

Hapi II

- Mësuesi/mësuesja vijon me rubrikën **Pasi lexove**, duke u drejtuar nxënësve pyetjet:
Për ç’arsye u larguan shkronjat dhe u nisën për rrugë?
Cila ishte gjendja e tyre “emocionale”?
Cilat qenë vështirësitë që kaluan?
Si mbyllet rrëfimi?
Çfarë premtoan në fund të rrëfimit?

Hapi III

Ky hap parashikohet të përmbushet jashtë orës mësimore përmes rubrikës **Detyrë** dhe që për këtë orë mësimore është:
Cila është marrëdhënia jote me leximin? A lexon vazhdimisht apo me ndërprerje? A mendon që ka ndonjë libër në bibliotekën tënde të cilin e ke lënë në harresë duke mos e lexuar dhe që, ashtu si edhe shkronjat në përrallën që lexove, ka të drejtë të jetë i “zemëruar” me ty?
Si do t’i kërkoje ti “falje” atij?

